



Alegri: "Ky Milan po rritet, mund të jemi edhe të tretët!"

Trajneri Masimiliano Allegri, pasi ka marrë konfirmimin e Adriano Galanit, kërkon të "karikojë" skuadrën e tij

FAQE 19



100 Vjet Pavarotti

Ferguson, arbitrit Ueb: "Ki kujdes nga Suarez!"

Sot, në orën 14:30, luhet superndeshja Mançester Junajtidi – Liverpul. Polemikat kanë nisur që herët

FAQE 21



SPORT EKSPRES

www.sportekspres.com

E DIEL, 13 JANAR 2013 | NR. 9 (4610) VITI | 18-TË | BOTIMIT | ÇMIMI: 30 LEKË/GREQI: 1.5 EURO

BLLOKIMI I ANKESËS PËR SHKODRËN

Shtyhet sërish gjyqi për Osmanin, Tan Bushati e telefonon si kuqebllu, e do në ekip

Nuk realizohet seanca në FSHF, pasi Vllaznia është justifikuar dje për moslajmërim. Trajneri i ardhshëm kërkon ta mbajë Tefikun në skuadër

FAQE 4



Rr. "Adem Jashari", Njësia Bashkiake Nr. 5, Tiranë
Tel: +355 4 226 7883
Fax: +355 4 224 8470
info@kevin.construksion.net
Cel: 0682022718

Skuadrës vlonjate i nevojitet një "dublues" për Migenin. Trajneri Gjoka pohon interesin e klubit për të plotësuar repartin ofensiv. Alternativa s'ka shumë, pritët "import" nga jashtë

FAQE 3

Flamurtari në sulm: "Dubloni" Memellin!

Ende asnjë lëvizje

Skënderbeu, zero transferta Josa: "Po ikën, të ikin shpejt"

FAQE 2

Tafaj në pritje

Tirana me sytë nga Gilmani, trajneri e kërkon publikisht

FAQE 4

Edhe sot ditë pune

Bashkia në hapat e fundit, Vllaznia e Çelës, po "shkrin"

FAQE 6

Një "çorbë" e madhe

Elbasani katastrofë, nuk ka asgjë, rrezikon daljen

FAQE 9

Tek Partizani Tifozët e kuq, të gatshëm për abonetë e reja



FAQE 9

Tek Lushnja Pas Dabullës dhe Çelës, rikthehet edhe Viktor Gjyla



FAQE 8



MAVRAJ

Rishfaqet Gallatasaraj

Mbrojtësi i Kombëtares, përtej interesit të Maincit, monitorohet edhe nga klubi i madh turk, por flitet për në fund të sezonit

Kapiteni i Greuther Furthit, Mërgim Mavraj, 26 vjeç, është gati për një eksperiencë të re, pas 3 vitesh të kaluar në Bavari

FAQE 11

DOSSIER/ Rrëfimi i fillimviteve '80 për volejbollin Edhe në volejboll fiton gjeopolitika

Përfundimi i Dinamos nga çerekfinalet e Kupës së Kampioneve në Volejboll për femra, në sezonin 1981-1982, është një shembull real se si federatat, gjeopolitikisht të dobëta, nuk mjaftohen vetëm të kenë një skuadër të mirë. Të paktën topi i volejbollit është rrotulluar...

Nga Xhiovani ARMILOTA



Dinamo e Keshnik Tartarit

FAQE 15



Edhe në volejboll fiton gjeopolitika

Rubrika të vërteta të fshehura: Përjashtimi i Dinamos nga çerekfinalet e Kupës së Kampioneve në Volejboll për femra, në sezonin 1981-1982, është një shembull real se si federatat, gjeopolitikisht të dobëta, nuk mjaftohet vetëm të kenë një skuadër të mirë. Të paktën topi i volejbollit është rrotulluar

Nga Xhiovani ARMILOTA

Në kërkim të padrejtësive sportive, që vijnë nga kombinimet e vërteta dhe nga komplotet kundër ndershmërisë dhe “fair-play”, nevojitet të merren në konsideratë shembuj të veçantë.

Në 1/8 e finaleve të Kupës së Kampioneve në Volejboll për femra, në sezonin 1981-1982, shqiptaret e Dinamos së Tiranës (dy herë finaliste të Kupës së Kampioneve në sezonin 1979-1980 dhe 1989-1990, si dhe e kualifikuar për në finalet e Kupës së Kupave në sezonin 1986-1987), kishin përballë gjermanet federale të Lohbof Unter-Shleihem, klub shumë i njohur dhe i përfshirë në Konfederatën Europiane (CEV). Gjermanet kishin fituar në shtëpi 3-0, në total të seteve 45-29, më 12 dhjetor 1981, por jashtë çdo parashikimi ato kanë humbur një javë më vonë me të njëjtin rezultat, 3-0, por me një diferencë pikësh më të keq sesa në ndeshjen e parë, 45-20. Gjithçka ka ndodhur më 19 dhjetor 1981 dhe Dinamo zyrtarisht ishte e kualifikuar në turin e ardhshëm të CEV-it. Skuadra kishte mësuar dhe datat dhe emrat e gjyqtarëve për dy ndeshjet e turit çerekfinale ndaj suedezëve të Solentuna Stokholm. Në mënyrë të pakuptimë dhe të tmerrshme, Dinamo përjashtohet nga çerekfinalet.

KLUBI I NËNSHTROHET NË SHANTAZHI TË TURPSHËM

CEV ishte i sigurt se shqiptaret do të kishin fituar përsëri dhe duke llogaritur që lojtarët e Uraločka Sverdlosk do të kishin mundur Dinamon e Bukureshtit, kishte lëshuar një paralajmërim. Më saktë, kishte kërkuar një “garanci” nga shqiptaret, nëse do të ishin të gatshme të luanin me sovjetiket.

Duke i dhënë të drejtë heshtjes së shqiptareve, CEV, me një pretekst që lidhej me rregullat e Kupave, ideale për drejtësi, me kuptimin e mirë dhe respekt, Konfederata Europiane vendos rikthimin të vendimit të fushës – pikërisht nga Konfederatat e njëjta – dhe skualifikon Dinamon. Po risjell për të gjithë, të përkthyer në italisht, Komunikatën Zyrtare të Federatës Shqiptare të Volejbollit, së cilës CEV nuk ka patur asnjëherë kurajo për t’iu përgjigjur. Një akt plot me akuza të Federatës Shqiptare të Volejbollit, me krenari të



Dinamo e Kreshnik Tartarit



Albert Saqellari, gjyqtari që “ndërseu” gjermanet

Ndeshjen Dinamo – Lohbof, 3-0, 19 dhjetor 1981, edhe pse kanë kaluar 31 vjet, shumë prej kryeqytetasve e mbajnë mend mirë. Vajzat e Kreshnik Tartarit, që nga Eva Kavaja, Donika Muka, Ela Tase, Mimoza Ibrahim, Lulëzime Duka, Eva Duni, Emona Gripshi etj., etj, kanë luajtur një ndeshje për t’u patur zili. Dhe në një pallat sporti “Partizani”, sot “Asllan Rusi”, ajo që mbahet mend është gjykimi i Saqellarit. Në çdo sulm të gjermaneve, menjëherë vinte vendimi për prekje të rrjetës, që acaroi mikeshat, deri në protesta, apo dhe reklamime të këtij lloji, që i hoqën të drejtën Dinamos për të vazhduar më tej në Kupën e Kampioneve.

madhe dhe njohje të plotë të së drejtës sportive.

PËRMbledhja e situatës, përtej të drejtës sportive

Në Kupën e Kampioneve për femra, në sezonin 1969-1970, 17 Nëntori mund Fenerbahçen e Stambollit dhe nuk ndeshet me sovjetiket. Federata Botërore e Volejbollit nuk merr asnjë masë ndaj shqiptareve dhe turqit do të luanin në çerekfinale ndaj CSKA të Moskës në vend të bardhebluve. Në kupën e Kampioneve për meshkuj, sezoni 1973-1974 (që nga ai sezon dhe më pas CEV do të fillonte zhvillimin e turneve sportiv, Partizani do të kalonte Ruinin e Firences dhe nuk pranon të marrë pjesë në grupin e gjysmëfinaleve, që do të luhej në Lajpsig, sepse merrnin pjesë bullgarët e CSKA së Sofjes. CEV nuk merr asnjë masë ndaj Partizanit dhe ital-

ianët do të shkonin në Gjermaninë Demokratike në vend të Klubit të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare. Në Kupën e Kupave për femra, në sezonin 1986-1987, Dinamo e Tiranës kualifikohet për në finalet e Izmirit duke eliminuar Mlladostin e Zagrebit, por nuk merr pjesë për të evituar takimet me sovjetiket e Komunalnik të Minskut (së bashku me Nelsen Rexhio Emilia dhe SG Jdz Feuerbah Shtutgard). CEV nuk merr asnjë masë ndaj Dinamos, ndërsa në vend të saj jugosllavet.

PSE VETËM NË KUPËN E KAMPIONEVE TË SEZONIT 1981-1982 CEV KËRKOI TË PENGONTE ME ÇDOMËNYRË SHQIPTARET?

Pasi Dinamo Tirana, nëse do të përballej me suedezët e Solentunës – duke njohur fitoren në fushë kundër va-


jazave të Lohbof – sigurisht, do të kalonin suedezët në finalen me katër dhe në këtë pikë do të kishim në fushë vajzat e Solentunës e jo gjermanet. Mbi të gjitha, në finalen me katër skuadra të luajtura në Ravena, të vjedhur Solentunës për motivet e thëna më lart, Lohbof “fitoi” medaljet e bronza.

VAZHDIMI I KONFIRMIMIT TË KEQ TË CEV ND AJ SHQIPTARËVE

Nevojitet të thuhet që gjatë sezonit në vazhdim, në takimin e luajtur në tokën shqiptare, për 1/8 e finaleve të Kupës së Kampioneve, në sezonin 1982-1983, (13 nëntor 1982, Dina-

mo Tirana – Mlladost Zagreb), CEV pat dërguar dy gjyqtarë grekë (Manolakis e Vasiladis); dhe vetëm 21 ditë më pas, për 1/8 e finaleve të Kupës së Kampioneve për femra, CEV do të dërgonte në Tiranë dy drejtues ndeshjesh jugosllavë (M.Dragan dhe M.Sloboda) në ndeshjen Dinamo-Ekzacibashi Stamboll (4 dhjetor 1982).

Sipas mendimit tim, zgjedhja për të mos i dhënë titullin ndërkombëtar arbitrave shqiptarë është e dallueshme dhe dominon, pasi Komiteti Organizator i Kampionateve Ballkanike të Volejbollit (atëherë përbëhej nga Shqipëria, Bullgaria, Greqia, Jugosllavia, Rumania dhe Turqia; mes kampionateve Botërore dhe Europiane, meshkuj e femra për kombëtarët dhe të rinjtë deri më 11 dhjetor 1981 janë shpërdarë 2 ari, 12 argjendi dhe 15 bronzi. Janë luajtur 9 Kupa Kampionesh, meshkuj e femra, 2 Kupa Kupash), i fton te gjyqtarët shqiptarë. Bilal Fuga (Kampionati Ballkanik për Kombëtarët A femra, 24-26 maj 1979 në Bukuresht); Babaçe Beqiri (Kampionati Ballkanik, 21-24 maj 1980, në Athinë për Kombëtarët A femra); Osman Plaku dhe Isa Boletini (ndër arbitrat më të mirë në Kampionatit Ballkanik, më 3-7 shtator 1980, në Bukuresht për Kombëtarët e të rejave); Andrea Zhor (Kampionati Ballkanik i të rinjve, në Kallamata Greqi, më 9-13 shtator 1981); Mitat Abdurahmani (9-13 shtator 1981, në Korinht të Greqisë, Kampionati Ballkanik i të rejave).



«Sporti popullor», Tirana, N. 3, 19 gennaio 1982, pag. 1

Komunikata e Federatës Shqiptare të Volejbollit

“Konfederata Europiane e Volejbollit ka vendosur që ndeshja mes skuadrave të femrave Dinamo Tirana-Lohbof të Republikës Federale të Gjermanisë, e zhvilluar në Tiranë më 19 dhjetor 1981, të përsëritet pasi është aktivizuar si gjyqtar i dytë një qytetar shqiptar me jo kategorinë përkatëse ndërkombëtare. CEV ka marrë shpjegimet përkatëse, teksa duhet nënvizuar: Për Federatën Shqiptare të Volejbollit vendimi i marrë nga CEV, në mënyrë të njëanshme, është i papranueshëm dhe arbitrar.

Për motive të tilla, Federata jep disa fakte konkrete.

E PARA: Me telegramin e datës 26 dhjetor, kjo Konfederatë njohet zyrtarisht se skuadra jonë Dinamo ka kaluar në turin e dytë të Kupës, ndërsa do të duhej të përballej me suedezët e Solentunës. Janë komunikuar dhe datat e arbitrat e këtyre ndeshjeve. Gjithmonë në këtë telegram, CEV kërkonte edhe garancinë tonë për të luajtur në finale me katër skuadra nga Hungaria, Bullgaria, Rumania dhe Bashkimi Sovjetik. Dhe kjo ende pa e ditur fundin e dy ndeshjeve Solentuna-Dinamo.

EDYTA: Në mënyrë të papritur dhe surprizë, më 29 dhjetor ka ardhur një tjetër vendim i CEV, që flet për një reklamim të klubit Lohbof të Republikës Federale Gjermane, që në fakt ka ardhur dhjetë ditë pas zhvillimit të kësaj ndeshjeje. Mbi të gjitha, në mbështetje të nenit 10 të Rregullores së Kupave të Europës, thuhet: “Reklamimet gjatë zhvillimit të një ndeshjeje ose për pjesëmarrjen e një skuadre duhet të jenë shoqëruar me protokollin e ndeshjes brenda 48 orëve pas mbarimit të takimit, së bashku me një letër rekomandë drejtuar CEV”. Në realitet, pas përfundimit të ndeshjes, protokollin ka qenë firmosur pa asnjë reklamim.

ETRETA: CEV është i vetëdijshëm që Federata Shqiptare e Volejbollit nuk ka arbitra volejbollit ndërkombëtarë, apo kandidatë për ndërkombëtarë. Gjyqtarët e dytë shqiptarë kanë qenë pjesëmarrës në takimet e luajtura në Tiranë, në të cilën ka marrë pjesë Dinamo, të paktën në tre edicionet e fundit të Kupave të Europës, si për

meshkuj, ashtu dhe për femra.

Mbi të gjitha, mbi bazën e kërkesës së CEV të dërguar me teletekst më 9 dhjetor 1981, Federata Shqiptare ka përvijuar listën e gjyqtarëve shqiptarë, të cilët do të mund t’i viheshin në dispozicion CEV për aktivitetin e Kupave të Europës, dhe ka kërkuar për t’i dhënë dhe titullin ndërkombëtar, apo dhe kandidat për ndërkombëtar. Kërkesë e cila nuk ka patur objeksione nga CEV, teksa në listë ishte përfshirë dhe emri i gjyqtarit të dytë të ndeshjes, Dinamo-Lohbof. Nëse për CEV arbitrat tanë pa kategori ndërkombëtare përbën një dhunim, atëherë pse i pranon kërkesat tona? Pse nuk merr masa për të dërguar dy gjyqtarë ndërkombëtarë të huaj?

Në vazhdim të vendimeve të njëanshme, CEV ka toleruar pjesëmarrjen e skuadrës Lohbof në Kupën e Kampioneve, edhe pse kjo skuadër është klasifikuar e dyta në Kampionatin e Volejbollit të Republikës Federale Gjermane. Në fakt, siç është shkruajtur nga gazeta “Sudojce Zeitung” e 6 prillit 1981, skuadra kampione e zyrtarizuar është USC Munster, siç është reklamuar zyrtarisht dhe nga Konfederata Europiane e Volejbollit (mund të lexohet që titulli i parë Kampion e Lohbof është në sezonin 1981-1982 dhe jo më 1980-1981), pra pas ndeshjeve me Dinamon. Që do të thotë një dhunim i nenit 1, pika 3, të Rregullores në bazë të së cilës pjesëmarrëse në Kupën e Kampioneve është vetëm skuadra kampione në fuqi.

Në dritën e këtyre fakteve, vendimi i Konfederatës Europiane të Volejbollit për përsëritjen e ndeshjes, apo dhe vendimi për ta luajtur këtë takim në një vend tjetër është në vazhdim e një serie aktesh të qëllimshme të diskriminimit të Federatës së Volejbollit të Shqipërisë, vendime që dikush i inkurajon dhe i manipulon me fakte aspak të vërteta.

Federata Shqiptare e Lojërave (volejbollit) nuk mund të jetë aspak dakord me vendime të tilla të padrejta. Duke përjashtuar në mënyrë kategorike zhvillimin e një ndeshjeje të tretë për Dinamon, duke qenë plotësisht e bindur në pozicionin e saj korrekt”.